



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.35.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AGJENCISË KUNDËR
KORRUPSIONIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Agjencisë Kundër Korrupsionit në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga Edona Abazi (Udhëheqëse e Ekipit) dhe Alban Beka (Anëtar i Ekipit).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	18
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	21

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 është ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me PVF-të. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në memorandumun e planifikimit të auditimit të datës 30 shtator 2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyrat vjetore financiare të theksuara në memon e planifikimit të auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Agjencisë Kundër Korrupsionit (duke përfshirë ekzekutimin e buxhetit dhe auditimin e brendshëm).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013, pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar).

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Agjencisë Kundër Korrupsionit kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Kontrollat efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të bëhet në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar. Adresimi i rekomandimeve ishte në një nivel të mirë. Kjo tregon gatishmërinë e menaxhmentit për të përmirësuar kontrollat në vazhdimësi.

Përpos progresit, në disa fusha nevojiten përmirësime të dukshme. Si fusha specifike për përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm të proceseve dhe kontrolleve të brendshme mbeten procedurat e prokurimit, menaxhimi i shpenzimeve të cilat nuk realizohen përmes procedurave të prokurimit dhe menaxhimi i pasurisë.

Ne nuk kemi ndonjë çështje me prioritet të lartë për të raportuar në këtë pjesë.

Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) të përgatisë pasqyrat vjetore financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar, rekomandimet e bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Në këtë raport kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme, sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshinë një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Disa deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

AKK, ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)**.

¹ Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh nëse:

- PVF-të janë përgatitur në pajtueshmëri me Rregullën Financiare (RrF) nr. 03/2013;
- Janë plotësuar kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- PVF-të janë pranuar në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- AKK, ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore në Ministri të Financave (MF) gjatë vitit 2013.

Sa i përket kërkesave më lartë, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrimi

Përveç hartimit të PVF-ve, nga AKK kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet operative vjetore (të performancës);
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit;
- Raportet mbi obligimet e papaguara të dorëzuara në MF;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit; dhe
- Planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Të gjitha kërkesat për raportim të jashtëm janë plotësuar me kohë nga AKK.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i AKK-së ka bërë progres të rëndësishëm në adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të vitit 2012. Kjo tregon gatishmërinë e tyre për të përmirësuar kontrollet në vazhdimësi.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 të AKK-së ka rezultuar me pesë (5) rekomandime kryesore. AKK kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet.

Nga rekomandimet e dhëna, katër (4) janë adresuar plotësisht, ndërsa një (1) është në proces të adresimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është e fokusuar në kuptimin dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti, për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe të kontrollit (MFK). Ne vlerësojmë nëse kontrollet janë dizajnuar mirë, janë implementuar sipas planit apo funksionojnë në mënyrë efektive. Për ta bërë këtë, nevojitet vlerësimi i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të paraqitura nga menaxhmenti. Ne konsiderojmë çështje të veçanta siç janë: aplikimi i vetë-vlerësimit të MFK-së dhe vlerësimi i rrezikut.

Duke ndjekur këshillën tonë, menaxhmenti i AKK-së ka kryer një proces të vetëvlerësimit, i cili do të zhvillohet në të ardhmen me mbështetje nga Ministria e Financave. Prosesi fillestar i vetëvlerësimit është një zhvillim pozitiv.

Menaxhmenti i Agjencisë Kundër Korrupsionit kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Kontrollet efektive kanë siguruar që menaxhimi i buxhetit të bëhet në pajtueshmëri me parimet e mirëfillta të menaxhimit financiar. Adresimi i rekomandimeve ishte në një nivel të mirë. Kjo tregon gatishmërinë e menaxhmentit për të përmirësuar kontrollet në vazhdimësi.

Përpos progresit, në disa fusha nevojiten përmirësime të dukshme. Si fusha specifike për përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm të kontrolleve të brendshme mbeten procedurat e prokurimit, menaxhimi i shpenzimeve të cilat nuk realizohen përmes procedurave të prokurimit dhe të menaxhimit të pasurisë.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për AKK-në dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	483,565	511,165	447,939	370,000	348,985
Granti i Qeverisë -Buxheti	483,565	483,565	447,939	370,000	348,985
Donacionet e Jashtme	-	27,600	-	-	-

Buxheti final në raport me atë fillestar është rritur për 27,600€, si rezultat i donacionit të Bakës Botërore në fund të vitit.

AKK gjatë vitit 2013 ka shpenzuar 447,939€ apo 88% të buxhetit final. Krahasuar me realizimin e buxhetit të vitit 2012 (prej 93%), për vitin 2013 vërejmë një rënie prej 5%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	483,565	511,165	447,939	370,000	348,985
Pagat dhe Mëditjet	293,709	293,709	286,822	236,679	234,848
Mallrat dhe Shërbimet	172,356	199,956	150,390	111,198	107,350
Shërbimet komunale	10,000	10,000	3,777	6,378	6,787
Subvencionet dhe Transferet	-	-	-	-	-
Investimet Kapitale	7,500	7,500	6,950	15,745	-

Sipas kategorive ekonomike vërehet një realizim i mirë i buxhetit (te kategoria e pagave dhe mëditjeve 98% dhe të investimet kapitale në 93%). Përrjashtim nga kjo bënë kategoria e mallrave dhe shërbimeve në të cilën realizimi i buxhetit ishte më i ulët me 75%. Faktor kryesor i realizimit të ulët në këtë kategori ishte rritja e buxhetit final si rezultat i donacioneve për 27,600€ në muajin dhjetor 2013.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Çështja 1 - Pagesa e shpenzimeve nga kategoria jo adekuate - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Dy pagesa në vlerë totale 8,991€ (Pagesa 2,976€, kodi ekonomik 'makina fotokopjuese', si dhe pagesa 6,015€, kodi 'pajisje tjera') ishin bërë për blerjen e tri fotokopjeve. Meqenëse vlera e tyre për njësi ishte mbi 1,000€, është dashur të realizohen nga kategoria e investimeve kapitale, përderisa ato janë realizuar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
- Rreziku** Regjistrimi i shpenzimeve në kategori ekonomike joadekuate, redukton efektivitetin e menaxhimit të buxhetit, saktësinë dhe plotësinë e raportimit financiar.
- Rekomandimi 1** Drejtori i AKK-së duhet të sigurojë kontrolle shtesë në kuadër të sektorit të pagesave, në mënyrë që shpenzimet të klasifikohen dhe regjistrohen në përputhje me planin kontabël të miratuar.

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

AKK gjatë vitit 2013 kishte shpenzuar gjithsej 447,939€, ku 59,932€ prej tyre janë realizuar përmes procedurave të prokurimit.

Ne kemi testuar 12 procedura të prokurimit në vlerë prej 49,707€ ose shprehur në përqindje 83%, e vlerës totale të kontratave të nënshkruara. Ne gjithashtu kemi testuar 36 pagesa të blerjeve të cilat kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit.

Çështja 2 - Mangësi në procesin e prokurimit të kontrata e servisimit të automjeteve - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) në fuqi për kontratat, çmimi i të cilave lidhet për njësi, procedura e prokurimit apo e blerjes duhet të bëhet me procedurë të hapur. Në testimin e kontratës 'Servisimi dhe Mirëmbajtja e automjeteve të AKK-së', kemi vërejtur që edhe pse kontrata është nënshkruar në bazë të çmimeve për njësi, zyrtari i prokurimit ka përdorur procedurat me kuotim të çmimit.

Gjatë testimit të po të njëjtës lëndë, kemi vërejtur që specifikacioni teknik i përgatitur nga njësia kërkuese nuk përputhet me specifikacionin teknik në dosje të tenderit. Njësia kërkuese kishte paraparë 63 njësi për katër vetura, ndërsa në dosje të tenderit ishin 130 njësi për tri vetura.

Më tutje sipas LPP-së, nëse një operator ekonomik (OE) dorëzon një tender që duket të jetë jo normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do t'i kërkoj sqarim me shkrim OE-së për sqarime lidhur me bazën e tenderit. Në procedurën e lartpërmendur kemi vërejtur se 60 njësi janë ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta nga të gjithë OE-të. Zyrtari i prokurimit nuk ka kërkuar sqarim me shkrim nga OE-ja për këto çmime.

Rreziku Menaxhimi i procedurave të prokurimit duke anashkaluar parimin e transparencës, konkurrencës, efikasitetit dhe efektivitetit, rrezikon vlerë të dobët për paranë e shpenzuar, duke paguar çmime më të larta për disa artikuj në raport me vlerën e tregut.

Rekomandimi 2 Drejtori i AKK-së duhet të sigurojë konkurrencë dhe transparencë të plotë gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, në mënyrë që paraja publike të shfrytëzohet në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive.

Çështja 3 - Furnizim me bileta pa kontratë dhe pa procedura të prokurimit - Prioritet i mesëm

E gjetura Tek avanset për udhëtime zyrtare në vlerë prej 3,000€ dhe 5,500€, kemi vërejtur se pagesat për biletë të udhëtimit prej 1,158€ dhe 1,925€, janë bërë pa procedura të prokurimit dhe pa ndonjë kontratë të nënshkruar.

Rreziku Furnizimi me bileta pa kontratë rritë rrezikun që të paguhen çmime më të larta se sa çmimet reale të tregut.

Rekomandimi 3 Drejtori i AKK-së duhet të rishikoj çështjen e transportit dhe të lidhë kontratë për furnizim me bileta me ndonjë agjent të udhëtimeve. Kontrata duhet të lidhet përmes procedurave të rregullta të prokurimit.

4.3.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Pjesa tjetër e shpenzimeve, i përket shpenzimeve të cilat nuk kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit. Ne kemi testuar gjithsej 12 pagesa në vlerë prej 21,905€ të blerjeve të këtij lloji shpenzimi. Gjatë testimit të këtyre pagesave ne kemi hasur në një çështje, si në vijim:

Çështja 4 - Regjistrimi në SIMFK pas pranimit të faturës - Prioritet i mesëm

E gjetura Për disa pagesa nuk janë respektuar rregullat e Thesarit për procesimin e tyre. Urdhërblerja si dhe pranimi mallit janë bërë pas pranimit të faturës.

Rreziku Kryerja e pagesave për mallra dhe shërbime para se të përcaktohen kërkesat/ nevojat, mund të rezultojë që të pranohen mallra të kualitetit të dobët dhe në vonesa të pagesave.

Rekomandimi 4 Drejtori i AKK-së duhet të forcoj kontrollat në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollat që operojnë në nivel të AKK-së, kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listat e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Buxheti final për Paga dhe Mëditje ishte 293,709€, ndërsa numri i buxhetuar i punonjësve ishte 40. Kurse, shpenzimet e realizuara për këtë kategori ishin 286,822€, dhe deri në muajin Dhjetor 2013 ishin 39 punonjës.

Gjatë auditimit ne kemi testuar 31 mostra, duke përfshirë procedurat e rekrutimit, dosjeve të personelit, rregullsinë e shpërndarjes së shujtave ditore dhe llogaritjet e pagave.

Çështja 5 - Anashkalim i kërkesave ligjore gjatë pagesës së pagave për punonjëset në pushim të lehonisë- Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas Rregullores për Pushimin e Nëpunësve Civil, paga për punonjëset të cilat janë në pushim të lehonisë, i takon përqindja e caktuar prej 70% në pagën bazë.

Në tri (3) raste kemi vërejtur se, kjo përqindje është zbatuar në pagën totale, duke përfshirë këtu edhe shtesat të cilat AKK i shpërndanë për stafin e tij (shtesa për rrezikshmëri 107€ dhe shtesa për shërbyesit civil prej 30€).

Rreziku Mungesa e kontrolleve në llogaritjen e pagave, rritë rrezikun që të bëhen pagesa për punonjësit pa bazë ligjore. Po ashtu, kjo mund të ndikojë që në të ardhmen të ketë edhe ndryshime tjera, të cilat janë të pa identifikueshme nga menaxhmenti.

Rekomandimi 5 Drejtori i AKK-së duhet të forcojë kontrollet e brendshme, në mënyrë që pagesa për pushim të lehonisë të llogaritet dhe të realizohet në përputhje me dispozitat në fuqi.

4.4 Pasuritë dhe Detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Sipas regjistrit kontabël (SIMFK), AKK për vitin 2013 zotëron gjithsej 34,007€ pasuri me vlerë mbi 1,000€. Sipas regjistrit E-pasuria 57,734€, janë pasuri nën 1,000€.

Ne kemi testuar nëse është implementuar rekomandimi lidhur me inventarizimin e pasurive, evidentimin e pasurive të përfituara gjatë vitit 2013 në regjistrat përkatës dhe harmonizimin e këtyre regjistrave me informacionet e prezantuara në PVF.

Çështja 6 - Mos harmonizim në mes të regjistrit të përgjithshëm të pasurive, regjistrit kontabël dhe regjistrit E-Pasuria - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas Rregullores për Menaxhimin e Pasurive, para prezantimit të tyre në PVF, Organizata Buxhetore (OB) duhet të bëjë fillimisht harmonizimin e vlerave të pasurisë në mes të regjistrave të mbajtura nga OB-ja në fjalë.
- Gjatë analizave të regjistrave të pasurive, kemi vërejtur që AKK nuk kishte siguruar informacione të plota në këto regjistra, ku në këtë rast asnjë prej regjistrave të kërkuara me ligj nuk harmonizohen në mes vete.
- Rreziku** Mos harmonizimi i informatave në këto regjistra mund të rezultojë në pasaktësi të raportimit dhe në mungesë të menaxhimit efektiv të pasurive. Kjo mund të ndikojë në përcaktimin jo adekuat të vjetërsisë apo në humbjen e pasurisë.
- Rekomandimi 6** Drejtori i AKK-së duhet të sigurojë se regjistrat e pasurisë janë harmonizuar në mes veti, në mënyrë që informatat e raportuara të jenë të plota dhe të sakta.

4.4.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Krahasuar me vitet paraprake, AKK për vitin 2013 kishte raportuar një vlerë më të ulët të detyrimeve, prej 1,963€ (977€ për mallra dhe shërbime dhe 986€ për shpenzime komunale).

Ne kemi testuar mënyrën e raportimit të tyre dhe kemi bërë teste substanciale. Bazuar në këtë kemi arritur në konkludim se AKK kishte raportuar obligimet sipas afatit ligjor, dhe njëkohësisht kishte prezantuar drejtë në PVF-të e vitit 2013.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Në bazë të kërkesave të parapara me U.A. nr.23/2009 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), AKK nuk i plotëson kushtet për themelimin e kësaj njësie.

Auditimin e brendshëm e kryen departamenti i auditimit të brendshëm në kuadër të MF-së. Ky auditim ishte realizuar gjatë muajit nëntor, ku përveç nëntëmujorit të vitit 2013 ishte audituar edhe tre mujori i fundit i vitit 2012. Në këtë raport janë të përfshira fushat të cilat janë audituar dhe tri rekomandime të drejtuara menaxhmentit.

Lidhur me këto rekomandime, menaxhmenti kishte përgatitur një plan detal për implementimin e rekomandimeve, si dhe afatet kohore për kompletimin e tyre.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4.2. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Te siguroj që planifikimi fillestar i buxhetit për kategorinë e Mallra dhe Shërbimeve përfshirë Shërbimet Komunale bëhet duke u bazuar në nevojat reale të agjencisë për kryerjen e aktiviteteve financiare dhe kontrollit gjatë tërë vitit.		Në raport me buxhetin fillestar, AKK kishte realizim të mirë të buxhetit, megjithatë për donacionin e pranuar në fund të vitit nuk kishte arritur të planifikonte realizimin e tij.	
4.4.1. Shpenzimet përmes prokurimit	Të siguroj proces të përhershëm të informimit të OE të pasuksesshëm. Kjo do ta zhvilloj transparencën dhe konkurrencën në blerje dhe më këtë rast OE-së i ofrohet mundësia e ankesës.	Po		
4.4.1. Shpenzimet përmes prokurimit	Të siguroj zbatimin e ndëshkimeve me qëllim të vetëdijesimit të OE për kryerjen e shërbimeve në mënyrë më efikase.	Po		
4.4.1. Shpenzimet përmes prokurimit	Para nënshkrimit të kontratës me operatorët ekonomik, menaxheri i prokurimit duhet të siguroj që ka aprovuar dhe nënshkruar raportin e vlerësimit të komisionit.	Po		
4.5.1. Menaxhimi i pasurive	Të siguroj informatat e nevojshme për komisionin e inventarizimit për të mundësuar kryerjen e inventarizimit dhe bazuar në atë raport të përditësohen regjistrat përkatës.	Po		